

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-074/13

Prishtinë, 8 Korrik 2015

Në çështjen juridike të:

F. G.

Pejë

Pala ankuese

Kundër

N. Z. S.

Serbi

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i apelit i AKP-së i gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, kryetari i kolegjit, Willem Brouwer dhe Rolandus Bruin gjyqtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/155/2012 të datës 6 qershor 2012 (lënda e regjistruar në AKP me nr. 34561) pas shqyrtimit të mbajtur më 8 Korrik 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

Hidhet poshtë si e papranueshme ankesa e F. G. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/155/2012 (lidhur me lëndën e regjistruar në AKP me numër KPA 34561) i datës 6 qershor 2012.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 27 nëntor 2007, Z. S. (në tekstin e mëtejshëm: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke e kërkuar si bartës i së drejtës pronësore, vërtetimin e të drejtës pronësore dhe të ri-posedimit ndaj ngastrave nr. 667, 668/1, 668/2, 669 me sipërfaqe 5 Ha 10Ari dhe 71 m², që ndodhen në fshatin Lumbardh, Komuna e Deçanit (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar). Ai ka deklaruar se e ka humbur pronësinë ndaj pronës më 12 qershor 1999 për shkak të konfliktit të armatosur të viteve 98/99 në Kosovë dhe që prona i ishte uzurpuar në mënyrë të kundërligjshme.
2. Kërkesa është regjistruar në AKP me numër KPA 34561.
3. Më 27 nëntor 2009, gjatë procesit në AKP, parashtruesi i kërkesës ndërroi jetë. AKP-ja ka kontaktuar me të birin e parashtruesit të kërkesës, N. Z. S. (në tekstin e mëtejshëm: pala përgjegjëse në ankesë). Pala përgjegjëse në ankesë ka deklaruar se është trashëgimtari i pronës së kërkuar dhe se qëndron pranë kërkesës së babait të tij në emrin e tij.
4. Së bashku me kërkesën, paraqitësi i kërkesës dhe pala përgjegjëse në ankesë, mes tjerash, ka dorëzuar edhe dokumentet vijuese:
 - Kontrata vr.nr.333-88, date 31 Maj 1998 mbi ndarjen e pronave të paluajtshme mes pesë trashëgimtarëve të M. S., e vërtetuar më 31 maj 1998 nga Gjykata Komonale e Deçanit. Sipas kësaj kontrate, pas ndarjes, paraqitësi i kërkesës ishte pronari i vetëm i pronës së kërkuar;
 - Certifikata e vdekjes e Z. S. e datës 22 dhjetor 2010, e lëshuar nga Komuna e Beogradit. Sipas kësaj certifikate paraqitësi i kërkesës ka ndërruar jetë më 27 nëntor 2009.
5. Dokumentet e lartpërmendura janë verifikuar pozitivisht nga ekipi verifikues i AKP-së.
6. Më 9 nëntor 2010 ekipi për njoftim i AKP-së bëri notifikimin me publikim të kërkesës duke vendosur një shenjë ku pretendohet se ndodheshin ngastrat. Sipas të dhënave në raportin njoftues të datës 9 dhjetor 2010, numrat e vjetër të ngastrave janë ndryshuar përkatësisht:

667 në 250

668/1 dhe 668/2 në 249

669 në 248

Gjatë njoftimit një preson i interesuar, B. G., në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në kërkesë, ka kërkuar të drejtën ligjore ndaj pronës së kërkuar dhe e ka nënshkruar njoftimin për pjesëmarrje si palë përgjegjëse në kërkesë.

7. Pala përgjegjëse në kërkesë, atëherë e ka kërkuar pronësinë ndaj pronës së kërkuar duke pohuar se ato i përkisnin gjyshit të saj. Më vonë, gjatë procedurës, pala përgjegjëse në kërkesë dhe avokati i saj kanë deklaruar se ajo dhe familja e saj nuk e kërkojnë pronën e kërkuar por ngastrat tjera, prona të paluajtshme në të cilat është e përfshirë (gjithashtu edhe familja paraqitësit të kërkesës.
8. AKP sipas detyrës zyrtare ia shtoi dosjes një certifikatë për të drejtat e pronësisë ndaj pronës së paluajtshme, e datës 4 qershor 2012, nr. UL-70505059-00101, lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale ne Decan. Sipas kësaj certifikate pala përgjegjëse në ankesë është pronare e pronës së kërkuar, në këtë certifikatë me numrat e ngastrave 248, 249 dhe 250.
9. Më 6 qershor 2012 me vendimin KPCC/D/A155/2012, KKPK-ja ka vendosur ta miratojë kërkesën me arsyetimin në paragrafët 18, 30 dhe 31, që biri i paraqitësit të kërkesës ka paraqitur prova të mjaftueshme që ai është pronari aktual i pronave të kërkuara.
10. Në vendimin e vërtetuar si paraqitës i kërkesës është përmendur : “Z.S.”.
Në vendim, mes tjerash, konstatohet se:
“ (a).*Paraqitësi i lartpërmendur i kërkesës ka vërtetuar që N. Z.S. është pronar i 1/1 të pronës së kërkuar:*
(b). Z. S. i jepet e drejta pronësore ndaj pronës së kërkuar;”
11. Vendimi i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë më 18 dhjetor 2012 dhe palës përgjegjëse në ankesë më 23 maj 2013.
12. Më 5 mars 2013 F.G.(në tekstin e mëtejme: pala ankuese) ka parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme duke e kundërshtuar vendimin e KPPK-së. Bashkë me ankesën ai, mes tjerash, ka dorëzuar këto dokumente:
 - Kontratën mbi blerjen e pronës së paluajtshme nr. 183/13, e datës 27 shkurt 2013, e lidhur mes D. Sh. dhe F. G. dhe e vërtetuar nga gjykata; subjekt i kontratës janë ngastrat me numër 153 dhe 154 në lokacionin Livadhet e Malit – Breg, Deçan.

- Certifikatën për pronën e paluajtshme nr. UL70505059-00102 të datës 4 mars 2013 të lëshuar nga Zyra kadastrale komunale e Deçanit. Certifikata ka të bëjë me ngastrat numër 153 dhe 154/3.
13. Ankesa i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 23 maj 2013.
 14. Pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur përgjigje në ankesë, e cila është pranuar nga AKP më 21 qershor 2013. Në përgjigje ai pretendon se ankesa është e papranueshme ngase pala ankuese nuk ka qenë palë pranë KPPK-së. Me këtë përgjigje ai parashtron kundërpadi. Ai pretendon se vendimi i vërtetuar mbi kërkesën përmban një gabim ku është shënuar paraqitësi i kërkesës, babai i palës përgjegjëse ne ankese, që i jepet e drejta pronësore ndaj pronës së kërkuar, ndërsa paraqitësi i kërkesës ka ndërruar jetë dhe pala ankuese e ka trashëguar pronën e pretenduar. Ai pretendon me kundërpadi ta ndryshojë dispozitivin e vendimit të vërtetuar të KPPK-së.
 15. Përgjigja i është dërguar palës ankuese më 20 mars 2015.
 16. Më 20 janar 2015 Gjykata Supreme me urdhër të saj ka kërkuar nga pala ankuese që brenda tre javësh të qartësojë se në çfarë cilësie dhe në bazë të cilave fakte ai ka të drejtë të paraqesë ankesë.
 17. Sipas fletë-dërgesës së AKP-së, pala ankuese e ka pranuar urdhrin e gjykatës më 3 shkurt 2015.
 18. Pala ankuese nuk iu përgjigj urdhrin të gjykatës brenda afatit kohor prej tre javësh.

Pretendimet e palëve:

19. Pala ankuese me ankesën e tij e kundërshtoi vendimin e KPPK-së. Ai i referohet kontratës së blerjes nr. 183/13, e datës 27 shkurt 2013, e lidhur mes D. Sh. dhe F. G. dhe e vërtetuar nga gjykata; subjekt i kontratës janë ngastrat me numër 153 dhe 154 në lokacionin Livadhet e Malit – Breg, Deçan.
20. Në anën tjetër pala përgjegjëse në ankesë deklaroi se ankesa është e papranueshme, sepse pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurë para AKP-së. Ai më tej pretendon se pronat të cilat pala ankuese i kërkon nuk janë të njëjta me ngastrat e kërkuara për të cilat është vendosur nga KPPK-ja me vendimin e ankimuar të KPPK-së.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

21. Ankesa e F. G. është e papranueshme.
22. Në bazë të nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që ndërlidhen me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji). Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, pala mund të paraqesë ankesë brenda 30 ditëve nga njoftimi i palës me vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore.
23. Në nenin 10, par.1 të Ligjit nr. 03/L-079 parashikohet se pas pranimit të kërkesës, sekretaria ekzekutive e AKP-së do ta njoftojë dhe do t'ia dërgojë një kopje të ankesës çdo personi tjetër pos paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht ka për qëllim të ketë të drejta mbi pronën e cila është objekt i kësaj kërkesë. Në nenin 10.2 të ligjit të njëjtë është theksuar se “çdo person tjetër pos paraqitësit të ankesës i cili aktualisht ka për qëllim të ketë të drejta mbi pronën e cila është objekt i kësaj kërkesë dhe/ose çdo person i cili mund të ketë interes ligjor në pronën e pretenduar do të jetë palë e kërkesës dhe e procedurës lidhur me atë me kusht që personi i atillë ta informojë sekretarinë ekzekutive për synimin e tij ose të saj që të merr pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditësh pas njoftimit për kërkesën nga ana e sekretarisë ekzekutive (...)”.
24. Nga dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-079 rrjedh se vetëm në procedurën e shkallës së parë ka të drejtë të paraqesë ankesë kundër vendimit të KKKP-së. Sipas praktikës gjyqësore të Kolegjit të Ankesave të AKP-ës të Gjykatës Supreme, vet përjashtimi i këtij rregulli del në pah nëse dhe kur personi i interesuar i cili e pretendon të drejtën ndaj pronës së kontestuar, nuk ka pasur dijeni dhe nuk ka mundur të ketë pasur dijeni për kërkesën e paraqitur në AKP shkak të mungesës së njoftimit të duhur mbi kërkesën dhe kështu nuk ka mundur të paraqesë njoftimin për pjesëmarrje.
25. Pala ankuese nuk ishte palë në procedurë pranë AKP-së dhe ai nuk ka shpjeguar nëse ka ndonjë afërsi me palën përgjegjëse në kërkesë në shkallë të parë. Ai më tej nuk ka shpjeguar pse ka interes ligjor ndaj pronës së kërkuar ngase provat që ka dërguar me ankesë nuk ndërlidhen me pronën e kërkuar por me ngastrat e tjera. Pasi që nuk ka arsyetim se pse ai nuk mori pjesë në shqyrtimin e shkallës së parë në AKP dhe nuk ka dëshmuar se ka interes ligjor në këtë rast, një gjë e këtillë shkon në dëm të tij.
26. Në këtë drejtim Gjykata Supreme gjithashtu konstaton se avokati përfaqësues i palës përgjegjëse në kërkesë në shkallën e parë kur është kontaktuar nga AKP-ja lidhur me ngastrat e kërkuara, ka konfirmuar se familja G. nuk e konteston pronësinë e palës përgjegjëse në ankesë ndaj ngastrave të kërkuara, të regjistruara në emrin e N. Z. S. por ngastrat që ndërlidhen me kushërinjtë e tij.

27. Gjykata Supreme e gjen të dobishme të konstatojë se çështja lëndore e kërkesës nr. KPA 34561 e vendosur me Vendimin Nr. KPPC/D/A/155/2012, ka të bëjë me ngastrat nr. 667, 668/1, 668/2, 669 dhe sipërfaqe 5 Ha 10Ari dhe 71 m2. Pretendimet e palës ankuese kanë të bëjnë me ngastrat nr. 153 dhe 154 që ndodhen në vendin e quajtur “Livadhet e Malit-Breg”.
28. Pasi që ankesa e palës ankuese është e papranueshme, Gjykata Supreme nuk duhet të vendosë për meritat e ankesës.
29. Lidhur me kundërpadinë e parashtruar në përgjigjen në ankese, Gjykata Supreme gjykon se bazuar në nenin 256 të LPK kundërpadia nuk mund të paraqitet në këtë fazë të gjykimit.
- Përfundimi:*
30. Nga arsyet e paraqitura dhe sipas nenit 13.3 të Ligjit Nr. 03/L-079 dhe nenit 195.1 nënparagrafi (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Prandaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin , Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it